



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:905267

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06036669

Ac.nr.5620/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci, kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Faton Ademi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të propozuesve të sigurimit – paditësve SH, SH, SH dhe S. B të gjithë nga P....., të të cilët sipas autorizimit i përfaqëson V.B, avokat nga P....., Rruga “Venet Behrami”, HY – B, R2 K1, Nr.06, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Rruga e “UÇK”, Nr.2, në Prishtinë, objekti i çështjes vërtetim i pronësisë, duke vendosur lidhur me propozimin e paditësve për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 09.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar propozimi i propozuesve të sigurimit - paditësve SH, SH, SH, S.B të gjitha nga Prishtina, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit, ashtu që t'i NDALOHET kundërshtares së sigurimit Komunës së Prishtinës, me adresë në Rruga “UÇK”, Nr.2, në Prishtinë, që të ndërmarrë veprime përmes të cilave mund të dëmtohet, tjetërsohet, fshehët, dhe ngarkohet pjesa e pasurisë, apo ti ndalohet kundërshtares së sigurimit të kryej punime në ngastrën kadastrale nr.02854-1, lloji i njësisë parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona rurale, lloji i shfrytëzimit bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasit të dytë, vendi i quajtur "Veternik", në sipërfaqe prej 13200 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në Certifikatën nr. UL-71914045-02854-1, ZK Prishtinë, KK Prishtinë, me qëllim të ruajtjes së pasurisë apo ruajtjes së gjendjes ekzistuese të rrethanave deri në vendosjen meritore të çështjes.

A r s y e t i m

Paditësit, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 24.05.2013 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në ngastrën kadastrale nr.02854-1, lloji i njësisë parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona rurale, lloji i shfrytëzimit bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasit të dytë, vendi i quajtur "Veternik", në

sipërfaqe prej 13200 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në Certifikatën nr. UL-71914045-02854-1, ZK Prishtinë, KK Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë pas mbetjes së seancave gjyqësore me Aktgjykimin C.nr. 21/22 të datës 16.02.2023, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, aktgjykim i cili sipas ankesës së ushtruara nga e paditura, i është përcjell Gjykatës së Apelit (kësaj gjykate), për vendosje përkitazi me ankesën e ushtruar.

Propozuesit e masës së sigurimit – Paditësit, me parashtresën e datës 15.007.2024, në këtë gjykatë kanë ushtruar propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndaj kundërshtares së sigurimit, me propozim që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit, ashtu që t'i NDALOHET kundërshtarës së sigurimit Komunës së Prishtinës, me adresë në Rruga "UÇK", Nr.2, në Prishtinë, që të ndërmarrë veprime përmes të cilave mund të dëmtohet, tjetërsohet, fshehët, dhe ngarkohet pjesa e pasurisë, apo të ndalohet Kundër-Propozuesja të kryej punime në ngastrën kadastrale nr.02854-1, lloji i njësisë parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona rurale, lloji i shfrytëzimit bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasit të dytë, vendi i quajtur "Veternik", në sipërfaqe prej 13200 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në Certifikatën nr. UL-71914045-02854-1, ZK Prishtinë, KK Prishtinë, me qëllim të ruajtjes së pasurisë apo ruajtjes së gjendjes ekzistuese të rrethanave deri në vendosjen meritore të çështjes

Me propozimin e ushtruar propozuesit kanë theksuar se kundërshtarja e sigurimit, gjatë implementimit të punimeve të njohura si "Rruga A", me pretendimin se e njëjta është pronare e ngastrës kadastrale objekt të çështjes ka filluar zgjerimin, prerjen e drunjëve dhe lirimim e hapësirës për fillimin e punimeve në ngastrën kadastrale me të dhënat e sipër cekura e cila është në shfrytëzim nga propozuesit, dhe për të cilën sipas aktgjykimit C.nr. 21/22 të datës 16.02.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, propozuesit e kanë fituar të drejtën e pronësisë si bashkëpronar mbi bazën e parashkrimit fitues. Propozuesit theksojnë se duke parasysh se me aktgjykim të shkallës së parë, propozuesit kanë fituar pronësisë, dhe lënda gjendet në trajtim në gjykatën e shkallës së dytë, të gjitha veprimet të cilat janë duke u ndërmarrë nga ana e kundërshtares së sigurimit, janë të kundërligjshme dhe mund të rrezikojnë tjetërsimin/ndryshimin e paluajtshmërisë për të cilën Propozuesit kanë fituar të drejtën e pronësisë. Andaj, në mënyrë që të pamundësohet çdo veprim i kundërshtares së sigurimit, që do të ndryshonte gjendjen qoftë edhe faktike, atëherë është urgjente nevoja që të caktohet masa e sigurisë në ngastrën kadastrale lëndore.

Kolegji i kësaj gjykate pas vlerësimit të propozimit të ushtruar për caktimin e masës së sigurimit dhe komplet shkresave të lëndës, duke vendosur në pajtim me dispozitën e nenit 296.1 të LPK-së gjeti se:

Propozimi i propozuesve, për caktimin e masës së sigurimit është i pabazuar. Propozuesit në rastin konkret me propozim nuk e kanë plotësuar asnjërin prej kushteve të cekura në nenin 297.1 të LPK-së, pasi nuk e kanë bërë të besueshme të drejtën e tyre subjektive e aq më pak kushtin e dytë ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit propozuesve do t'iu pamundësohej apo vështirësohej realizimin i të drejtës së tyre subjektive. Aktgjykimi i cili nuk është i formës së prerë nuk mund të shërbej si bazë për ekzistimin e të drejtës subjektive sepse në fazën në të cilën është nuk ka asnjë efekt i njëjti pa marrë formën e prerë.

Me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së parashihet se për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen dy kushte kumulative. Kushti i parë është që propozuesi i sigurimit ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, ndërsa kushti i dytë është që të ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave ose do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Me nenin 304 paragrafi 3 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë po që se ka mundësi, që mjetet provuese t'ia bashkëngjitë propozimit “.*

Propozuesi në propozim e thekson se: kundërshtari i sigurimit ka ndërmarr veprime për hapjen e rrugës “A” që nënkupton punët si zgjerim, pastaj punët tjera me rastin e shtrimit të rrugës, andaj ka kërkuar që gjykata me masë t'ia ndalojë kundërshtarit të sigurimit ndërmarrjen e veprimeve. Ndërmarrja e veprimeve të kundërshtarit të sigurimit në këtë fazë është plotësisht e ligjshme sepse prona evidentohet si pronë shoqërore, pastaj veprimet e ndërmarra janë në interes publik, andaj me masë në asnjë variant propozuesit nuk do të mund t'ia ndalonin ndërmarrjen e veprimeve kundërshtarit të sigurimit.

Rrjedhimisht nga të lart cekurat rezulton se meqë në rastin konkret për caktimin e masës së sigurimit kumulativisht duhet të plotësohen kushtet e parapara me dispozitën e nenit 297.1 pika a) dhe b) dhe par.2 të kësaj dispozite, e çka në rastin konkret rezulton se nuk janë plotësuar kushtet në mënyrë kumulative të parapara me këtë dispozitë ligjore, gjykata mbi këtë bazë vendosi që propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit ta refuzoj si të pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lart gjykata konform dispozitës së nenit 296.1 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.5620/2023 me datë 09.08.2024

Kryetari i kolegjit,  
Adnan Konushevc

**KËSHILLË JURIDIKE:**  
Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.